



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 8/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me nr. REF-72977-09-24-2020, me objekt Lotin I “Materiale Kancelarie me bazë letre” me fondin limit 4,279,447 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 30.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara

Ankimues: “Rama Graf” sh.p.k.
Lagjia: “5 Maji” , pranë ekonomikut Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

Subjekt i Interesuar: “Interlogistic” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Rruga Dytësore, Km.9, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përçaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.09.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me nr. REF-72977-09-24-2020, me objekt Lotin I “Materiale Kancelarie me bazë letre” me fondin limit 4,279,447 Lekë pa tvsh , zhvilluar në datën 30.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 30.10.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 12.11.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Interlogistic” sh.p.k.	2.011.738 lekë, kualifikuar
2. “Rama Graf” sh.p.k.	2.561.870 lekë, kualifikuar
3. “Infosoft Office” sh.p.k.	2.700.000 lekë, kualifikuar
4. “Marketing & Distribution” sh.p.k.	3.623.827 lekë, kualifikuar
5. “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k.	3.700.000 lekë, kualifikuar
6. “Dynmicx Group” sh.p.k.	3.704.320 lekë skualifikuar

II.4. Në datën 12.10.2020 operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k., duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Autoriteti kontraktor më datë 13.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSh) përkatësisht:

1. “Interlogistic” sh.p.k.	2.011.738 lekë, kualifikuar
2. “Rama Graf” sh.p.k.	2.561.870 lekë, kualifikuar
3. “Infosoft Office” sh.p.k.	2.700.000 lekë, kualifikuar
4. “Marketing & Distribution” sh.p.k.	3.623.827 lekë, kualifikuar
5. “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k.	3.700.000 lekë, kualifikuar
6. “Dynmicx Group” sh.p.k.	3.704.320 lekë skualifikuar

Duke qënë se ky vlerësim i bërë nga KVO-ja e AK-së është i gabuar dhe bie në kundërtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës në fuqi, mbështetur në nenin 63 pika 2 e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe VKM-së RrPP-së i ndryshuar në vijim të procesit të vlerësimit të ofertave për tenderin dhe brenda afatit 7 ditor nga dita e nesërme e punës e njoftimit të këtij vendimi më poshtë po ju paraqesim kundërshtitë tona mbi arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshtitë tona. Operatori “Interlogistic” sh.p.k., ka paraqitur ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në dst për këtë procedurë prokurimi është 4.279.447 lekë pa TVSH .Thënë ndryshe kjo ofertë është 53% më e ulët se vlera e fondit limit si dhe 31% më e ulët se mesatarja e ofertave të vlefshme të të gjithë oe-ve pjesmarrës mesatarja e të cilave është në vlerën 2.919.487 lekë pa TVSH . Mjaftojnë vetëm këto vlera të dhëna matematikore që kjo ofertë ekonomike e paraqitur nga oe “Interlogistic” sh.p.k., të konsiderohet e pa pranueshme nga AK për më tepër se nga 5 operatorët ekonomikë pjesmarrës të kualifikuar vetëm 1 operator “Interlogistic” sh.p.k ka paraqitur ofertën anomalisht të ulët e cila rrit më tepër mosbesimin për realizimin e kontratës në bazë të fondit limit.

Sqarimi se oe “Interlogistic” sh.p.k. drejtuar AK-së nuk është aspak i saktë pasi në bazë të LPP-së nenin 56 pika 1 Për ofertën anomalisht të ulët ku thuhet: Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta,

ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës.... më konkretisht.....

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Nuk është bërë analizë ekonomike për sasi të pritshme të artikujve sipas DST.

Nuk ka ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm për kryerjen e punimeve dhe për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

Nuk janë paraqitur sqarimet dhe dokumentacion i plotë që të vërtetojë origjinalitetin e mallit apo shërbimit.

Nuk është paraqitur dokumentacion për zbatueshmërinë që lidhet me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet puna.

Duke pasur parasysh mosargumentimin e pikave a,b,c, d dhe një preventivi të saktë duke mos paraqitur asnjë provë shkresore bindëse sic kërkohet në ofertat anomalisht të ulëta firma "Interlogistic" sh.p.k. nuk është në rregull me gjithë elementët e saj që e garantojnë realizimin e kontratës.

Përsa më sipër në përputhje me nenin 56 të LPP- i ndryshuar nenit 66 pika 5 e VKM-së RrPP-së pikës 4.1 të Manulait nr. 02 datë 06.02.2018 të APP-së të pikës 3.3 të OT në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi Autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të duhet të konsiderojë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik "Interlogistic" sh.p.kb të skualifikoj këtë operator ekonomik si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit operatorin ekonomik "Rama Graf" sh.p.k. [...]

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresën nr.2314/3 prot, datë 23.11.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik "Rama Graf" sh.p.k., duke e refuzuar atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik, procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë mbi kualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin "Interlogistic" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me date 12.11.2020 kualifikimit e ofertes se tij. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Interlogistic" shpk dhe konstatoi:

Ne nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon se "Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me cmim anomalisht

te ulet sipas formule se percaktuar ne dokumentet standarde te tenderit. Perlllogaritja e ofertes anomalisht te ulet behet ne menyrt e meposhtme: - Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56 te LP P, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25% e fondit limit te perlllogaritur. Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me e vogel se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56 te LPP. Ne cdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentojte dhe te dokumentojte me prova shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP."

Nga verifikimi i ofertes ekonomike te ofertuesit "Interlogistic" SHPK, oferta ekonomike e paraqitur, ne zbatim te nenit 66 pika 5 te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulet.

Ne pikat 1 dhe 2 te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se: "1.Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per: a) anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi; 9) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. "; "2.Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur.

Autoriteti kontraktor mund ta refuzojte oferten, kur edhe pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj".

Ne zbatim te nenit te sipercituar ne daten 06.11.2020 Komisioni i Vleresimit te Ofertave, me ane te shkreses nr. 2233 prot., me objekt "Kerkese per informacion mbi oferten anomalisht te ulet", i ka kerkuar ofertuesit "Interlogistic" SHPK sqarim per oferten ekonomike me vlere 2,011,738 leke (pa TVSH) per proceduren e prokurimit me objekt "Blerje Materiale Kancelarie" e ndare ne 3 (tre) Lote, me konkretisht: Loti I "Materiale Kancelarie me baze letrre".

Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kerkuar sqarimet si vijon: se gjate procesit te shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave, nga anetaret e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, eshte konstatuar se oferta e paraqitur, nga ana juaj, rezulton anomalisht e ulet, Perpara se te vazhdojme me procesin e vleresimit te ofertave, ju kerkojme te paraqisni me shkrim/ne rruge elektronike dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes tuaj, per: a) anen ekonomike te procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshern, qe ju keni per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ana juaj; 9) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. Po ashtu, ju njoftojme se keni detyrimin te argumentoni dhe te dokumentoni me prova

shkresore sqarimet per elementin/elementet e vecanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP. Autoriteti kontraktor do t'i verifikojë keto elemente dhe ne baze te informacionit te paraqitur nga ana juaj, mund ta pranojë oferten ose mund ta refuzojë atë, nese pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur, nga ana juaj, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj.

Ne daten 09 .11.2020 prane organit qendror bleres, ofertuesi "Interlogistic" shpk brenda afatit kohor te percaktuar ka sjell shkresen ku ka argumentuar oferten anomalisht te ulet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga ana e ofertuesit rezulton se ne permbushje te parashikimeve te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, jane dorezuar pershkrime narrative si edhe dokumentacion shoqerues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik te ofertes se dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, per proceduren e prokurimit me objekt "Blerje Materiale Kancelarie" e ndare ne 3 (tre) Lote me konkretisht: Loti I "Materiale Kancelarie me baze letre".

Konkretisht, ne lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1, te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ofertuesi "Interlogistic" SHPK ka dorezuar deklarata doganore, vertetimet per pagesat e detyrimeve, certifikata, sqarime per kostot e produkte etj.

Sa me siper eshte gjykuar se me ane te dokumentacionit te dorezuar ofertuesi "Interlogistic" SHPK permbush kater kushtet kumulative te kerkuara nga ligji i posacem ne drejtim te argumentimit te ofertes ekonomike anomalisht te ulet.

Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Rama Graf" SHPK nuk pranohet

Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.[...]

II.7. Në datën 27.11.2020 operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k.. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Autoriteti kontraktor më datë 13.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatoëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSh) përkatësisht:

1.	“Interlogictic” sh.p.k.	2.011.738 lekë, kualifikuar
2.	“Rama Graf” sh.p.k.	2.561.870 lekë, kualifikuar
3.	“Infosoft Office” sh.p.k.	2.700.000 lekë, kualifikuar
4.	“Marketing & Disstribution” sh.p.k.	3.623.827 lekë, kualifikuar
5.	“IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k.	3.700.000 lekë, kualifikuar
6.	“Dymicx Group” sh.p.k.	3.704.320 lekë skualifikuar

Duke qënë se ky vlerësim i bërë nga KVO-ja e AK-së është i gabuar dhe bie në kundësthim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës në fuqi, mbështetur në nenin 63 pika 2 e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe VKM-së RrPP-së i ndryshuar në vijim të procesit të vlerësimit të ofertave për tenderin dhe brenda afatit 7 ditor nga diuta e nesërme e punës e njoftimit të këtij vendimi më poshtë po ju paraqesim kundështitë tona mbi arsyet ligjore ku bazohen këto kundështitë tona. Operatori “Interlogistic” sh.p.k., ka paraqitur ofertë ekonomike tërësisht dhe anomalisht të ulët. Fondi limit i percaktuar në dst për këtë procedurë prokurimi është

4.279.447 lekë pa TVSH .Thënë ndryshe kjo ofertë është 53% më e ulët se vlera e fondit limit si dhe 31% më e ulët se mesatarja e ofertave të vlefshme të të gjithë oe-ve pjesmarrës mesatarja e të cilave është në vlerën 2.919.487 lekë pa TVSH . Mjaftojnë vetëm këto vlera të dhëna matematikore që kjo ofertë ekonomike e paraqitur nga oe “Interlogistic” sh.p.k., të konsiderohet e pa pranueshme nga AK për më tepër se nga 5 operatorët ekonomikë pjesmarrës të kualifikuar vetëm 1 operator “Interlogistic” sh.p.k ka paraqitur ofertën anomalisht të ulët e cila rrit më tepër mosbesimin për realizimin e kontratës në bazë të fondit limit.

Sqarimi se oe “Interlogistic” sh.p.k. drejtuar AK-së nuk është aspak i saktë pasi në bazë të LPP-së nenin 56 pika 1 Për ofertën anomalisht të ulët ku thuhet: Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës.... më konkretisht.....

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Nuk është bërë analizë ekonomike për sasi të e pritshme të artikujve sipas DST.

Nuk ka ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm për kryerjen e punimeve dhe për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

Nuk janë paraqitur sqarimet dhe dokumentacion i plotë që të vërtetojë origjinalitetin e mallit apo shërbimit.

Nuk është paraqitur dokumentacion për zbatueshmërinë që lidhet me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet puna.

Duke pasur parasysh mosargumentimin e pikave a,b,c, d dhe një preventivi të saktë duke mos paraqitur asnjë provë shkresore bindëse sic kërkohet në ofertat anomalisht të ulëta firma “Interlogistic” sh.p.k. nuk është në rregull me gjithë elementët e saj që e garantojnë realizimin e kontratës.

Bazuar sa më sipër me të njëjtin problematikë ankimimi për ofertën anomalisht të ulët për pikat a,b,c,d. KPP në vendimet me nr. 398/2019, 686/3/2019; nr. 430/2020 I ka dhënë të drejtë operatorit ekonomik ankimues. Kërkojmë hetimin gjithëpërfshirës të dokumentacionit të firmës “Interlogistic” dorëuar AK në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër në përputhje me nenin 56 të LPP- i ndryshuar nenit 66 pika 5 e VKM-së RrPP-së pikës 4.1 të Manulait nr. 02 datë 06.02.2018 të APP-së të pikës 3.3 të OT në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi Autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të duhej të konsiderojë të pavlefshme dhe të papranueshme ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. të skualifikoj këtë operator ekonomik si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit operatorin ekonomik “Rama Graf” sh.p.k. [...]

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2413/1 prot., datë 11.12.2020,protokolluar me tonën në datën 15.12.2020, me objekt “Informacion”, si dhe shkresës nr. 2539/1prot., datë 31.12.2020, protokolluar me tonën nr. 1582/4 prot., datë 07.01.2021 me objekt “dërgohet informacion shitesë për procedurën e prokurimit me objekt Loti I Materiale kancelarie me bazë letre”, është

depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rama Graf” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. *si ofertë anomalisht e ulët*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 12 “Sasia dhe Grafiku i lëvrimit”, është përcaktuar si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti I “Materiale kancelarie me bazë letre”			
NR	EMERTIMI I ARTIKUJVE	NJESIA	SASIA
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5, min 300 faqe	copë	25
2	Axhendë ditore afërsisht 17.2x24, min 300 faqe	copë	150
3	Bllok kartvizitash min 50 vende	copë	10
4	Bllok A4 kapak imitacion lëkure	copë	305
5	Bllok A4 kapak i forte, 168 fletë	copë	80
6	Bllok shënimesh A5, 60 fletë	copë	150
7	Bllok A5 kapak i fortë 48 fl	copë	50
8	Bllok shënimesh adeziv	copë	80
9	Blloqe porosish	copë	100

10	<i>Blloqe shënimesh adesiv</i>	<i>copë</i>	100
11	<i>Bllok mandat arkëtim 3 kopje</i>	<i>copë</i>	5
12	<i>Bllok mandat pagese 3 kopje</i>	<i>copë</i>	5
13	<i>Bllok Fletë-Dalje 3C A5</i>	<i>copë</i>	240
14	<i>Bllok Fletë-Hyrje 3C A5</i>	<i>copë</i>	130
15	<i>Bllok Urdhër dorëzimi</i>	<i>copë</i>	40
16	<i>Ditar llogarie</i>	<i>copë</i>	1
17	<i>Ditar të ardhurash</i>	<i>copë</i>	1
18	<i>Dosje me mekanizëm, 7cm</i>	<i>copë</i>	550
19	<i>Dosje me mekanizëm, kartoni, 5 cm</i>	<i>copë</i>	120
20	<i>Dosje me mekanizëm,plastike, 7 cm</i>	<i>copë</i>	120
21	<i>Dosje plastike me llastik, 3 cm</i>	<i>copë</i>	50
22	<i>Dosje kartoni e thjeshtë e bardhë</i>	<i>copë</i>	6200
23	<i>Dosje arkive lidhëse STASH 15 cm</i>	<i>copë</i>	250
24	<i>Dosje arkive buton kartoni 6 cm</i>	<i>copë</i>	150
25	<i>Dosje arkive buton kartoni 10 cm</i>	<i>copë</i>	150
26	<i>Dosje kartoni e thjeshtë me xhep të brendshëm</i>	<i>copë</i>	2000
27	<i>Dosje kartoni me llastik</i>	<i>copë</i>	1600
28	<i>Dosje kartoni me llastik 2 cm</i>	<i>copë</i>	200
29	<i>Dosje kartoni me llastik 5 cm</i>	<i>copë</i>	120
30	<i>Dosje kartoni me llastik 10cm</i>	<i>copë</i>	100
31	<i>Dosje kapak plastik me 2 kapëse</i>	<i>copë</i>	500
32	<i>Dosje konference kapak imitacion lekure me xhep</i>	<i>copë</i>	10

33	<i>Dosje me 30 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	30
34	<i>Dosje me 50 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	40
35	<i>Dosje me 80 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	10
36	<i>Dosje personeli</i>	<i>copë</i>	850
37	<i>Fletë ankesë për personel dhe punonjës</i>	<i>copë</i>	2
38	<i>Kalendar tavoline</i>	<i>copë</i>	250
39	<i>Kartela magazine</i>	<i>fletë</i>	500
40	<i>Kapak linoje lustër</i>	<i>fletë</i>	500
41	<i>Kapak transparent për lidhje</i>	<i>fletë</i>	500
42	<i>Kuti arkive</i>	<i>copë</i>	200
43	<i>Kub plastik me letra shënimesh</i>	<i>copë</i>	10
44	<i>Kub shënimesh me ngjitje</i>	<i>copë</i>	230
45	<i>Kub shënimesh me ngjitje</i>	<i>copë</i>	30
46	<i>Ndarëse për dosje, me gërma alfabeti A-Z,</i>	<i>copë</i>	5
47	<i>Ndarëse letre 40 fletë</i>	<i>copë</i>	30
48	<i>Libër protokolli 200 fletë</i>	<i>copë</i>	1
49	<i>Libër protokolli 400 fletë</i>	<i>copë</i>	31
50	<i>Libër Paga</i>	<i>copë</i>	1
51	<i>Libër Arke</i>	<i>copë</i>	1
52	<i>Libër i dorëzimit të informacionit të paklasifikuar Model 4/1, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	1
53	<i>Libër amze për regjistrimin e kursantëve, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	1
54	<i>Libreza shëndetsore kuadri</i>	<i>copë</i>	10
55	<i>Libër magazine, 200 fletë</i>	<i>copë</i>	100

56	<i>Libër poste, 100 flete.</i>	<i>copë</i>	151
57	<i>Libër Dorëzimi korespondence, 150 fletë.</i>	<i>copë</i>	76
58	<i>Libër i dorëzimit të korespondencë së informacionit të klasifikuar "sekret shteteror"</i>	<i>copë</i>	1
59	<i>Libër Debi - Kredi</i>	<i>copë</i>	10
60	<i>Libri i daljes së përkohshme e armatimit 50 flete</i>	<i>copë</i>	201
61	<i>Libri i kontrollit të automjeteve në objekt 50 fletë</i>	<i>copë</i>	121
62	<i>Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim 50 fletë</i>	<i>copë</i>	201
63	<i>Libri i lënies së adresave 50 fletë</i>	<i>copë</i>	121
64	<i>Libri i lëvizjes së automjeteve 50 fletë</i>	<i>copë</i>	141
65	<i>Libri i planizimit të shërbimit, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	1700
66	<i>Libri i proçes-verbaleve , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	40
67	<i>Libri i vizitorëve në objekt, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	250
68	<i>Libri i marrje-dorëzim shërbimi nga roja 50 fletë</i>	<i>copë</i>	1650
69	<i>Libri i planizim-shërbimit, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	170
70	<i>Libri Shërbimi i oficerit të rojes, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	1200
71	<i>Libri i shërbimit të rojes në objekt, , 50 flete</i>	<i>copë</i>	40
72	<i>Evidence shërbimi 50 fletë</i>	<i>copë</i>	640
73	<i>Libër i instruktazhit të personelit të shërbimit , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	100

74	<i>Libër i kontrollit të objekteve, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>125</i>
75	<i>Libër i kontrollit të punimeve në objekt, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>120</i>
76	<i>Libër i kontrollit të korespondencës zyrtare , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>120</i>
77	<i>Libër i kontrollit të pakove, sendeve, objekteve, dhuratave etj, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>120</i>
78	<i>Libër i kontrollit të eskortave, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>
79	<i>Libri i Dinamikes së Veprimtarisë, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>80</i>
80	<i>Libri i kontrollit të lejimit për qitje</i>	<i>copë</i>	<i>320</i>
81	<i>Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>320</i>
82	<i>Libër shërbimi me tre turne, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>340</i>
83	<i>Libër shërbimi me dy turne, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>170</i>
84	<i>Libër shërbimi me një turn, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>65</i>
85	<i>Libër shërbimi Asistuesi, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>65</i>
86	<i>Regjistër korespondence</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
87	<i>Regjistër sekretimi i informacionit të paklasifikuar. Model 1, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
88	<i>Regjistër protokollimit të dokumentave të paklasifikuar. Model 1;Model 4, 197 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>

89	Regjistër sekretimi i informacionit të paklasifikuar. Model 1; 200 fletë	copë	1
90	Regjistër korospondence model 1-3, 100 fletë	copë	1
91	Regjistër shperndarje, 100 fletë	copë	1
92	Regjistër Personeli, 150 fletë	copë	1
93	Regjistër i qarkullimit brendshem të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" , 50 fletë	copë	1
94	Indeks Alfabetik, 70 fletë	copë	1
95	Regjistër i regjistrave të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", 50 fletë	copë	1
96	Regjistër I korrespondencës së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", 200 fletë	copë	1
97	Regjistër i korrespondencës ,100 flete	copë	1
98	Regjistër i korrespondencës, 200 flete	copë	1
99	Regjistër i korrespondencës, , 100 flete	copë	1
100	Regjistër i korrespondencës., 300 flete	copë	51
101	Regjistër I kerkesë – ankese, 60 flete	copë	1
102	Regjistër i korrespondencës klasifikuar "sekret shtetëror", 100 flete, 100 flete	copë	1
103	Regjistër i korrespondencës klasifikuar "sekret shtetëror", 150 fletë.	copë	1

10 4	Zarfa 30x40	copë	2000
10 5	Zarfa 11x23	copë	3500
10 6	Zarfa 19x26 (A5)	copë	6500
10 7	Zarfa 23x33 (A4)	copë	7500
10 8	Zarfa plastik me vrima	pako	470
10 9	Rregjister I evidentimit mjeteve ne park A4 me 200 flete	Copë	8
11 0	Fletë udhëtimi I mjeteve blloqe me 100 fletë	blloqe	160

Ndërsa në dokumentat e tenderit Shtojca 9“Specifikimet teknike”, është përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Loti I : "Materiale Kancelarie me bazë letre" - Specifikime Teknike të unifikuara

Nr.	Emërtimi	Njësia	Specifikime teknike
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5, min 300 faqe	copë	Axhenda ditore të ketë permasat 14.2x20.5cm (± marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti, me logo ose jo sipas kërkesës së AK, me ngjyrë të zezë, blu, ose tjetër sipas kërkesës së AK.
2	Axhendë ditore afërsisht 17.2x24, min 300 faqe	copë	Axhenda ditore të ketë përmasat 17.2x24cm, minimumi të ketë 300 faqe,ngjyra të ndryshme, sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, të shkruhet viti,me

			<i>logo ose jo sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.</i>
3	<i>Blllok kartvizitash min 50 vende</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok kartvizitash 50 vende:të ketë cilësi dhe hapsirë të mjaftueshme për vendosjen e kartvizitave.</i>
4	<i>Blllok A4 kapak imitacion lëkure</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok A4 kapak imitacion lëkure: të ketë permasat A4, kapak imitacion lëkure, ngjyrë të kuqe, e zezë, blu ...etj. fletë A4 me vija ose katrore, nr i fleteve 100/120 të jetë me ngjitje.</i>
5	<i>Blllok A4 kapak i forte, 168 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok A4 , me leter me vija ose kuadrate, kapak i fortë kartoni ngjyra të ndryshme, min 168 fletë.</i>
6	<i>Blllok shënimesh A5, 60 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok A5,me leter me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, min 60 fletë me lidhje spirale.</i>
7	<i>Blllok A5 kapak i fortë 48 fl</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok A5, min 48 flete,me letër me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme.</i>
8	<i>Blllok shënimesh adeziv</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok shenimesh, material adeziv, përmasa 75-127 me ngjitje.</i>
9	<i>Bllloqe porosish</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok me ngjitje, adeziv përmasa 75x75, 100 flete.</i>
10	<i>Bllloqe shënimesh adesiv</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok, material adeziv, përmasa 38x50, me ngjitje,</i>
11	<i>Blllok mandat arkëtim 3 kopje</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok për mandat Arkëtimi me 3 kopje ngjyra të ndryshme, me rubrika sipas kërkesës</i>
12	<i>Blllok mandat pagese 3 kopje</i>	<i>copë</i>	<i>Blllok mandat Pagese me rubrikat sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me ngjitje, 3 kopje me ngjyra te ndryshme.</i>
13	<i>Blllok Fletë-Dalje 3C A5</i>	<i>copë</i>	<i>Bllloku të jetë me rubrika të ndara,me 3 kopje ngjyra të ndryshme të jetë me ngjitje, me kapak të fortë kartoni, A5</i>

14	<i>Bllok Fletë-Hyrje 3C A5</i>	<i>copë</i>	<i>Bllok Fletë-Hyrje, me 3 kopje ngjyra të ndryshme, me rubrikat sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor</i>
15	<i>Bllok Urdhër dorëzimi</i>	<i>copë</i>	<i>Blloku të jetë me rubrika të ndara sipas kërkesës së AK, të jetë me ngjitje, me kapak të fortë kartoni, A5, me 2 kopje, minimumi të jetë me 100 flete pa kapakun.</i>
16	<i>Ditar llogarie</i>	<i>copë</i>	<i>Ditar me rubrikat e llogarisë, me kapak kartoni të fortë, me lidhje.</i>
17	<i>Ditar të ardhurash</i>	<i>copë</i>	<i>Ditar me rubrikat të ardhurave, me kapak kartoni të fortë, me lidhje.</i>
18	<i>Dosje me mekanizëm, 7cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28*35x 7 cm, me kuti, ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.</i>
19	<i>Dosje me mekanizëm, kartoni, 5 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje me mekanizëm A 4 me fiksuese, 28*35x 5 cm, me kuti, ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.</i>
20	<i>Dosje me mekanizëm,plastike, 7 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje me mekanizëm të jetë prej plastike, me trashësi 7cm, përmasa afersisht 31x29x7,të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.</i>
21	<i>Dosje plastike me llastik, 3 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje plastike me llastik, të jetë, trashësia 3 cm, të ketë nga brenda kapak për fiksimin e materialeve, të ketë llastik për fiksimin e materialeve, ngjyra të ndryshme.</i>
22	<i>Dosje kartoni e thjeshtë e bardhë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë material kartoni, përmasa 25x34,me me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) minimumi 9cm . Peshë e dosjes min 60 gr</i>

23	<i>Dosje arkive lidhëse STASH 15 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë karton I trashë,të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore,të jetë me përmasa 35x24.5x15 cm, ngjyra të ndryshme. Pesha e dosjes min 375gr</i>
24	<i>Dosje arkive buton kartoni 6 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë karton i trashë,të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore,të jetë me përmasa 35x24.5x6 cm, ngjyra të ndryshme. Pesha e dosjes min 265gr</i>
25	<i>Dosje arkive buton kartoni 10 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë material me trashësi 1.1 mm,të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore,të jetë me përmasa 34x24x10 cm, ngjyra të ndryshme.</i>
26	<i>Dosje kartoni e thjeshtë me xhep të brendshëm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje kartoni , me xhep të brendshëm për mbajtjen e materialeve, me lluster,Përmasa 24*32cm, pesha e dosjes afersisht 50gr</i>
27	<i>Dosje kartoni me llastik</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material kartoni, me lluster nga jashtë, të jetë me llastik, të ketë nga brenda me veshë ne anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 25x34.5cm. Pesha e dosjes min 101gr</i>
28	<i>Dosje kartoni me llastik 2 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material kartoni, me lluster nga jashtë, të jetë me llastik të trashë, të ketë nga brenda me veshë ne anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 25x34.5x2cm. Pesha e dosjes min 234 gr</i>

29	<i>Dosje kartoni me llastik 5 cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik të trashë ,trashësia e llastikut 1.2cm ,të ketë nga brenda me veshë ne anësore per mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 25x34.5x5cm. Pesha e dosjes min 353 gr</i>
30	<i>Dosje kartoni me llastik 10cm</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik , të ketë nga brenda me veshë ne anësore per mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 25x34.5x10cm.</i>
31	<i>Dosje kapak plastik me 2 kapëse</i>	<i>copë</i>	<i>Dosja të jetë material plastik, të ketë nga brenda 2 kapëse për fiksimin e materialeve, kapaku i parë të jetë transparent kapaku i dytë të jetë me ngjyra të ndryshme.</i>
32	<i>Dosje konference kapak imitacion lekure me xhep</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë me imitacion lëkure, format A4, të ketë xhep të brendshëm për mbajtjen e dokumentacve, të ketë te stampuar logon e AK.</i>
33	<i>Dosje me 30 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë plastike, format A4, Të jetë me 30 zarfa plastike, trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 min. Të ketë xhep anësor për vendosje etikete</i>
34	<i>Dosje me 50 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë plastike, format A4, Të jetë me 50 zarfa plastike, trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 mic. Të ketë xhep anësor për vendosje etikete</i>
35	<i>Dosje me 80 zarfa plastik</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë plastike, format A4, Të jetë me 80 zarfa plastike, trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 mic. Të ketë xhep ballor për format A4 për vendosje etikete A4.</i>

36	<i>Dosje personeli</i>	<i>copë</i>	<i>Dosje personeli, materiali PVC, ngjyra të ndryshme sipas kërkesës së AK, me kapse metalike të brendeshme, përmasat e dosjes 32 x 24 x 2 cm. ±marzh gabimi. Në Pamjen ballore (kapakun e dosjes) të jetë e stampuar: Stema e Republikës së Shqipërisë, Republika e Shqipërise, Emri i institucionit përkatës sipas kërkesës, me madhësi shkrimi 12 dhe gërma kapitale. Në qendër të dosjes të shkruhet Dosje Personeli (me madhësi shkrimi 14 dhe gërma kapitale). Në pjesën e poshtme të shkruhet Nr.Dosjes dhe në fund Emër, Atësia Mbiemër. Dosja të mbyllet me dy llastiqe anesore në krahun e djathtë te saj. Në krahun e majtë të dosjes në pjesën e brendeshme, të ketë 2 xhepa të brendëshem për fotografi të përmasave 9x12 cm dhe 4x6 cm ±marzh gabimi. Në krahun e djathtë të dosjes, në pjesën e brendëshme të ketë xhep me përmasat 30 x 15 cm.</i>
37	<i>Fletë ankesë për personel dhe punonjës</i>	<i>copë</i>	<i>Të jetë me rubrikat e kërkuara nga AK .</i>
38	<i>Kalendar tavoline</i>	<i>copë</i>	<i>Kalendar Tavoline me kapak të forte të papërthyeshem me lidhje me spirale, me përmasa 29.8x10.5cm , me 62 fletë, 1 flete të ketë një javë.</i>
39	<i>Kartela magazine</i>	<i>fletë</i>	<i>Të ketë kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhe, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor dhe me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.</i>
40	<i>Kapak linoje lustër</i>	<i>fletë</i>	<i>Kapak kartoni A4, përmasa A4 (270 g/m²), me ngjyra të ndryshme paketim deri në 100 fletë.Kapakë kartoni me sipërfaqe me relief ose lino 270 gr. (ngjyra ndryshme)</i>

41	Kapak transparent për lidhje	fletë	Formati A4, i tejdukshëm, të ketë opsion lidhje me ngjitje dhe spirale.
42	Kuti arkive	copë	Të ketë përmasa 410x280x170 mm, material kartoni të forta.me kapak Karton i trashë,pesha e dosjes afërsisht 800gr
43	Kub plastik me letra shënimesh	copë	Letra shënimesh me mbajtëse plastike. Të jetë me ngjitje, përmasa 50x90x90, ngjyrë e bardhë, jo më pak se 400 fletë. Materiali mbajtëses të jetë plastik.
44	Kub shënimesh me ngjitje	copë	Kub shënimesh me ngjitje.Përmasa 50x75, ngjyra të ndryshme, jo më pak se 400 fletë,
45	Kub shënimesh me ngjitje	copë	Kub shënimesh me ngjitje.Përmasa 50x75, ngjyra të ndryshme, jo më pak se 100 fletë,
46	Ndarëse për dosje, me gërma alfabeti A-Z,	copë	Ndarëse për dosje, të jetë shkronja A-Z, material karton. me ngjyra të ndryshme.
47	Ndarëse letre 40 fletë	copë	Ndarëse për letër, të jetë 50x20, 4 ngjyra me nga 40 fletë
48	Libër protokolli 200 fletë	copë	Të jetë sipas modelit të përcaktuar për protokoll, me lidhje, jo më pak se 200 fletë
49	Libër protokolli 400 fletë	copë	Të jetë sipas modelit të përcaktuar për protokoll, me lidhje, jo me pak se 400 fletë
50	Libër Paga	copë	Libër formati page, me lidhje, jo më pak se 200 fletë,
51	Libër Arke	copë	Libër Arke me min 100 fletë pa kapakun, kapaku të jetë karton cilësor i trashë, qepje me lidhje, përmasa A4. Rubrikat të jenë të ndara sipas kërkesave të AK.
52	Libër i dorëzimit të informacionit të paklasifikuar Model 4/1, 100 fletë	copë	Me kapak të trashë, sipas modelit, ngjyra fletës e bardhë, vijat ndarëse brenda fletës të jetë 1 e trashuar, 4 të tjera të jenë normale, me rubrika sipas kësës së Autoritetit Kontraktor. Përmasa 35x25, jo më pak se 100 fletë. Përmasat 28x21x100 fletë (ngjyre e bardhë)

53	<i>Libër amze për regjistrimin e kursantëve, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Format A3, me kapak kartoni, me fletë të bardhë, jo më pak se 100 fletë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Fletë ngjyrë e bardhë</i>
54	<i>Libreza shëndetsore kuadri</i>	<i>copë</i>	<i>Me kapak kartoni, lidhje me tel në anësor, me rubrikat e përcaktura nga Autoriteti Kontraktor.</i>
55	<i>Libër magazine, 200 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Sipas modelit përcaktuar me të gjitha rubrikat, me kapak kartoni të fortë, me fletë të bardhë, 200 flete, me ngjitje, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor</i>
56	<i>Libër poste, 100 flete.</i>	<i>copë</i>	<i>Kapak kartoni, me ngjitje, sipas modelit të përcaktuar, fletë e bardhë, 100 fletë, me rubrika sipas kërkesës së AK.</i>
57	<i>Libër Dorëzimi korespondence, 150 fletë.</i>	<i>copë</i>	<i>Model 4, me kapak të fortë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, përmasa 30x21, përfshire marzhi i gabimit, 150 fletë.</i>
58	<i>Libër i dorëzimit të korespondencë së informacionit te klasifikuar "sekret shteteror"</i>	<i>copë</i>	<i>Model 4, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor ,përmasa 29.5x21, 150 fletë,</i>
59	<i>Libër Debi - Kredi</i>	<i>copë</i>	<i>Libër formati Debi-Kredi, me lidhje, jo më pak se 200 fletë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me kapak kartoni.</i>
60	<i>Libri i daljes së përkohshme e armatimit 50 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i daljes së përkohshme e armatimit të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>

61	<i>Libri i kontrollit të automjeteve në objekt 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i kontrollit të automjeteve në objekt të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 flete, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
62	<i>Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i kontrollit dhe lejimit për shërbim të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
63	<i>Libri i lënies së adresave 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i lënies së adresave të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
64	<i>Libri i lëvizjes së automjeteve 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
65	<i>Libri i planizimit të shërbimit, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i planizimit të shërbimit të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
66	<i>Libri i proçes-verbaleve , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>

67	<i>Libri i vizitorëve në objekt, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i vizitorëve në objekt të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
68	<i>Libri i marrje-dorëzim shërbimi nga roja 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i marrje-dorëzim shërbimi nga roja të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
69	<i>Libri i planizim-shërbimit, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë me leter 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 flete, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
70	<i>Libri Shërbimi i oficerit të rojes, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i Shërbimi i oficerit të rojes të jenë me leter 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
71	<i>Libri i shërbimit të rojes në objekt, , 50 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i shërbimit të rojes në objekt të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
72	<i>Evidence shërbimi 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Evidence shërbimi të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>

73	<i>Libër i instruktazhit të personelit të shërbimit , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër i instruktazhit të personelit të shërbimit të të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
74	<i>Libër i kontrollit të objekteve, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër i kontrollit të objekteve të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga te dyja anet sipas modeleve të përcaktuara.</i>
75	<i>Libër i kontrollit të punimeve në objekt, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
76	<i>Libër i kontrollit të korespondencës zyrtare , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
77	<i>Libër i kontrollit të pakove, sendeve, objekteve, dhuratave etj, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër i kontrollit të pakove, sendeve, objekteve, dhuratave etj, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
78	<i>Libër i kontrollit të eskortave, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër i kontrollit të eskortave, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor</i>

			<i>nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
79	<i>Libri i Dinamikës së Veprimtarisë, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i Dinamikës së Veprimtarisë, të jene me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së AK nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
80	<i>Libri i kontrollit të lejimit për qitje</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i kontrollit të lejimit për qitje, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së AK nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
81	<i>Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libri i shërbimit përgjegjës ruajtje objekti të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
82	<i>Libër shërbimi me tre turne, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër shërbimi me tre turne, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së AK nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
83	<i>Libër shërbimi me dy turne, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër shërbimi me dy turne, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>

84	<i>Libër shërbimi me nje turn, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër shërbimi me nje turne, të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
85	<i>Libër shërbimi Asistuesi, 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Libër shërbimi Asistuesi. Të jenë me letër 80gr offset me qepje dhe ngjitje, 50 fletë, kapaku të jetë me karton 250gr, ngjyra dhe rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor nga të dyja anët sipas modeleve të përcaktuara.</i>
86	<i>Regjistër korespondence</i>	<i>copë</i>	<i>Regjistri të jetë me kapak të fortë, me lidhje, fletë të bardhë. Rubrikat të jenë të shënuara sipas kërkesës dhe nevojës së AK.</i>
87	<i>Regjistër sekretimi i informacionit të paklasifikuar. Model 1, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak te trashë kartoni, ngjyra e fletes të jetë e bardhe, me rubrika sipas kërkesëa së Autoritetit Kontraktor ,përmasa 35x24, 100 fletë,</i>
88	<i>Regjistër protokollimit te dokumentave te paklasifikuar. Model 1;Model 4, 197 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Regjistër protokollimit të dokumentave të paklasifikuar. Model 1;Model 4 përmasat 29x19x197 fletë, me kapak të trashë kartoni , ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit kontraktor</i>
89	<i>Regjistër sekretimi i informacionit të paklasifikuar. Model 1; 200 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhe, me rubrika sipas kërkesës së AK, përmasa 30x21, 200 fletë,</i>
90	<i>Regjistër korespondence model 1-3, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Regjister korespondence model 1-3, me 100 fletë, kapak të fortë, me lidhje, flete të bardhë</i>
91	<i>Regjistër shpërndarje, 100 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Regjistër shpërndarje, Model-4 , me 100 fletë, kapak të fortë, me lidhje, fletë të bardhë,të jetë shënuar në çdo fletë</i>

92	<i>Regjistër Personeli, 150 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Regjistër personeli , me 150 fletë, kapak të fortë, me lidhje, fletë të bardhë,të jetë shënuar në çdo fletë</i>
93	<i>Regjistër i qarkullimit brendshëm të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror" , 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Model 4, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor ,përmasa 29.5x21, 50 fletë,</i>
94	<i>Indeks Alfabetik, 70 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Format A4, të ketë indeksi 36 gërma(sipas alfabetit), përmasat 29.5x21, deri 70 fletë</i>
95	<i>Regjistër i regjistrave të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", 50 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Format A-4, sipas modelit bashklidhur, përmasa 29.5 x21, deri 50 fletë</i>
96	<i>Regjistër I korrespondencës së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", 200 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Format A3, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, përmasa 42x29, 200 fletë, me rubrika sipas kërkesës së AK.</i>
97	<i>Regjistër i korrespondencës. ,100 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së AK, përmasa 30x21,100 fletë,</i>
98	<i>Regjistër i korrespondencës, 200 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së AK, përmasa 30x21, 200 fletë,</i>
99	<i>Regjistër i korrespondencës, , 100 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor me rubrikat sipas kërkesës së AK, përmasa 42x29, 100 fletë.</i>

100	<i>Regjistër i korrespondencës., 300 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor me rubrikat sipas kërkesës së AK,përmasa 42x29,300 fletë,</i>
101	<i>Regjistër I kerkese – ankese, 60 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrikat sipas kërkesës së AK,përmasa 42x29, 60 fletë,</i>
102	<i>Regjistër i korrespondencës klasifikuar "sekret shtetëror", 100 flete, 100 flete</i>	<i>copë</i>	<i>Format A4, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së AK me rubrikat sipas kërkesës së AK,përmasa 42x29 , 100 fletë.</i>
103	<i>Regjistër i korrespondencës klasifikuar "sekret shtetëror", 150 fletë.</i>	<i>copë</i>	<i>Model 1, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, përmasa 33x25, 150 fletë.</i>
104	<i>Zarfa 30x40</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë letre, material cilësor përmasat 30x40, me mbyllje me ngjitje,</i>
105	<i>Zarfa 11x23</i>	<i>copë</i>	<i>Zarfi të ketë përmasat 11x23 me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë</i>
106	<i>Zarfa 19x26 (A5)</i>	<i>copë</i>	<i>Zarfi të ketë përmasat 19x26me mbyllje me ngjitje, ngjyrë e bardhë</i>
107	<i>Zarfa 23x33 (A4)</i>	<i>copë</i>	<i>Të jenë letre, përmasat23x33 me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë</i>
108	<i>Zarfa plastik me vrima</i>	<i>pako</i>	<i>Material plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe.</i>
109	<i>Regjistër I evidentimit mjeteve në park A4 me 200 fletë</i>	<i>copë</i>	<i>Format A4, me kapak të trashë kartoni, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së AK sipas modelit bashkëlidhur,përmasa 42x29 , 200 fletë.</i>
110	<i>Fletë udhëtimi I mjeteve blloqe me 100 fletë</i>	<i>blloqe</i>	<i>Format A4, ngjyra e fletës të jetë e bardhë, me rubrika sipas kërkesës së AK sipas modelit bashkëlidhur blloqe me 100 fletë, sasia</i>

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...]”

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

III.1.4. Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.
- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e

vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e rrishtit që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë

mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k., si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, oferta ekonomike e paraqitur nga ky i fundit, në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 06.11.2020, me anë të një kërkesë, autoriteti kontraktor ka kërkuar operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k., informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, sipas të cilës është kërkuar (citojmë) “*[...] ju njoftojmë se gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, është konstatuar se oferta e paraqitur nga ana juaj rezulton anomalisht e ulët.*

Përpara se të vazhdojmë me procesin e vlerësimit të ofertave ju kërkojmë të paraqisni me shkrim në rrugë elektronike dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për element të vecantë të ofertës tuaj për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

Po ashtu ju njoftojmë se keni detyrimin të argumentoni me prova shkresore sqarimet për elementin/elementët e vecantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së. Autoriteti kontraktor do të verifikojë këto element bazë të informacionit të paraqitur nga ana juaj mund ta pranojë ofertën ose mund ta refuzojë atë, nëse sipas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ana juaj nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjithë elementët e saj. Për shpejtësi veprimesh kërkesa ju dërgohet edhe në formë elektronike në ëëë.app.gov.al[...].

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se operatori ekonomik “Interlogistic” sh.p.k., në datën 09.11.2020 ka kthyer përgjigje protokolluar me nr. 2233/1 prot.,09.11.2020 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, shkresa me objekt “*Sqarim për ofertë anomalisht të ulët*” e operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k.,në të cilën ka paraqitur një përshkrim të ofertës së tij (citojmë):

“ [...] Kompania jonë ka një eksperiencë 10 vjecare në sektorin tregtim të letrës, tonerave kancelarisë dhe prokurimeve përkatëse. Në lidhje me cmimet e ofertës të dorëzuar në procedurë Loti I “Materiale kancelarie me bazë letre” theksojmë se cmimet janë marrë nga furnitorët tonë në bazë të raportit shumë vjecar dhe rritjes të volumit të blerjes nga viti në vit.

Cmimet tona janë cmimet ekonomiksht të favorshme si pasojë e bashkëpunimit afatgjatë me partnerët tanë të mëdhenj ndërkombëtar. Si rezultat i këtij bashkëpunimi shumëvjecar kompania

jonë favorizohet nga furnitorët duke marrë zbritje preferenciale për produkte të ndryshme në varësi të shitjeve dhe të suksesit që kanë produktet specifike në treg. Këto cmime janë cmime që pasqyrohen në të njëjtën linjë në të gjitha prokurimet që ne kuotojmë. Oferta është vlerësim i kostove aktuale të produkteve tona.

Në lidhje me kërkesën për sqarim në ofertën anomalisht të ulët si pasqyrim kosto, donim tju bënim me dije se kostoja e kuotuar nga ana jonë përfaqëson një analizë të detajuar jo vetëm nga ana e kostove por edhe nga raporti i stokut të produkteve NPI. (Non performing Inventory ose inventar jo performues). Inventari joperformues ka një afat kohor në të cilin duhet të dali në shitje nga magazina. Gjithashtu vlen të theksohet dhe fakti që në raste të tilla kur produktet kanë shitje të vogël si pasojë e bashkëpunimit shumëvjeçar që kemi me furnitorët ato na bëjnë zbritje për këto produkte për të na mundësuar pastrimin e mallit nga magazina. Produkte me rotacion të lartë në ofertën tonë është bashkëngjitur marxhi i duhur dhe inventari joperformues është optimizuar në cmimin e duhur për të nxjerrë këtë produkt në shitje. Cmimi i dhënë për klëtë lot pasqyron analizë të cdo produkti në koston e tij të optimizuar sipas performancës si produkt. Për cdo informacion shtesë jeni të lutur të na kontaktoni[...]" bashkëlidhur:

Vërtetim për pagim detyrimesh. nr. T03101080 datë 06.11.2020 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e taksave .

Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin –E-SIG 02/a nr. T03101068 datë 06.11.2020.

Deklaratë doganore Importi me nr. R 45 datë 21.05.2020 artikujt: X, X, X, X, X kusht lëvrimi DAP me vlerë X €.

Deklaratë doganore Importi me nr. R 44 datë 14.05.2020 me artikujt: X , X, X; X; X; X; X; X; X; X; X; X kusht lëvrimi DAP me vlerë X €.

Certifikatë për vërtetim pronësie 1666161

Certifikatë për vërtetim pronësie 1666159

Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pjesëmarrje në tender nr. 865prot datë 28.04.2020 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj.

Certifikatë për sigurinë nga zjarri (ripërtëritje për lejim aktiviteti) nr. I-13336/1 prot., datë 07.08.2020 lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së

Certifikatë për sigurinë nga zjarri (ripërtëritje për lejim aktiviteti) nr. I-13398/1 prot., datë 07.08.2020 lëshuar nga Drejtoria e MZSH-së

Vërtetim nr. 9611/1 datë 29.10.2020 lëshuar nga OSHEE.

Certifikata nr. 055.2/16SCR ISO 45001:2018 (Interlogistic" sh.p.k.).

Certifikata nr. 104/17 ISO 9001:2015 (Interlogistic" sh.p.k.).

Certifikata nr. 384/14 UNE-EN-ISO 14001:2015 (Interlogistic" sh.p.k.).

III.1.8. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se operatori ekonomik "Interlogistic" sh.p.k., për argumentimin e ofertës së tij si ofertë anomalisht e ulët, ka paraqitur deklarata doganore për disa zëra, Iso, Vertetim OSHEE, Certifikata për vertetim pronësie, Vertetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Vërtetim për shlyerjen e taksave.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik "Interlogistic" sh.p.k. nga ku rezulton se ka paraqitur ofertën ekonomike, e cila rezulton se është anomalisht e ulët dhe, sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori

ekonomik të paraqitej argumentimi i ofertës në përputhje me përcaktimet e nenit 56 të ligjit për prokurimin publik.

III.1.10. Përpara se të marrë në analizë materialin justifikues/argumentues të operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson ti referohet edhe praktikës e legjislacionit të BE mbi çështjen. Kështu, në çështjen precedent *Lombardini and Mantovani* (C-285/99 [2001] ECR I-9233), Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) u shpreh se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t’i skualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni European, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit European (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t’i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rin negociuar fondin limit pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve, apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni European ka deklaruar se ky është një problem i hasur posaçërisht në industrinë e ndërtimit (dokumenti “Parandalimi, Zbulimi dhe Përfundimi i Ofertave Anomalisht të Ulëta në Industrinë Europiane të Ndërtimit” *DG III 5 Qershor 1999*). Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar.

III.1.11. Duke u rikthyer në çështjen tonë, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët krahas deklaratave doganore për disa zëra, Iso, Vertetim OSHEE, Certifikata për vertetim pronësie, Vertetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Vërtetim për shlyerjen e taksave është dorëzuar edhe dokumenti “*Sqarim për ofertë anomalisht të ulët*”, i protokolluar në datën 09.11.2020 nga autoriteti kontraktor në të cilën përveç argumentimit të vet në formën e një narrative ku shpjegon në të gjitha paragrafët e saj se është një kompani me eksperiencë 10 (dhjetë) vjeçare në sektorin e letrës tonerave kancelarisë etj, nuk ka paraqitur asgjë për zbërthimin e anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, një nga komponentët e rëndësishëm të nenit 56 të LPP. Referuar argumentimit të ofertës anomalisht të ulët në asnjë pikë nuk i referohet përmbushjes së gërmës a) të nenit 56 të LPP ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjithë elementët. Operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesi të detajuar analizën e kostos së mallit në rastin konkret dhe në cdo rast ta argumentojë me prova dhe fakte si dhe të justifikojë cmimin e ofertuar për cdo zë. Sikundër arsyetuar më lart operatorët që ofertojnë në kushtet e ofertës anomalisht të ulët në kuptim të nenit 56 të LPP duhet të plotësojnë njëherazi katër kushte kumulative në mënyrë që oferta e tyre të krijojë bindjen e një oferte të sukseshme

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se vërtet ligjvënësia ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta, por në cdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rrezik për realizimin me sukses të kontratës me cmimin e ofertuar dhe se në këtë cmim janë të përfshira të gjithë elementët e kostos të nevojshme dhe të

detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 56 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku dy prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar në Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.12. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

III.1.13. Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori ekonomik duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, ndërsa thekson nevojën e kërimit të dokumentacionit shpjegues/argumentues nga një operator ekonomik oferta e të cilit është identifikuar në bazë të formulës ligjore si anomalisht e ulët, përpara sesa autoriteti kontraktor ta skualifikojë atë, nuk mund të mos tërheqë vëmendjen e autoriteteve kontraktore se parimi e kriteri kryesor për përcaktimin e një oferte si fituese nuk është çmimi më i ulët, por vlera më e mirë që mund të përfitohet nga paraja (publike), ose e thënë ndryshe, shërbimi/malli/puna më e mirë duke përmbushur kriteret kualifikuese, që mund të blihet me çmimin më të ulët që i siguron ato.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rama Graf” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me nr. REF-72977-09-24-2020, me objekt Lotin I “Materiale Kancelarie me bazë letre” me fondin limit 4,279,447 Lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Rama Graf” sh.p.k.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1582Protokolli

Datë 27.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri